



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 02.06.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. të protokollit APK-DPKI-06-206/25, për zyrtarin e lartë z. Visar Haxhibeqiri, Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një denoncimi nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

"[...] "Visar Haxhibeqiri Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë, gjithashtu është anëtar i përhershëm i Komisionit Profesional Shqyrtues në IKMM-Prishtinë. Sipas informacioneve që ne disponojmë, në kuadër të propozimeve për investime kapitale për vitin 2024-2025, që ka bërë Qendra e Gjakovës, është aprovuar financimi për ndihmën në restaurimin e shtëpisë së stërgjyshit të tij, Beqir (Avdush) Haxhibeqiri, me një vlerë prej 250 mijë eurosh. Kjo pronë, sipas regjistrave të tanishëm, ka qenë në "Mbrotjtje të Përkohshme", ndërkohë që tani rezulton te jetë vlerësuar me 250 mijë euro, çka ka bërë që të kalojë në "Mbrotjtje të Përhershme. Nga hulumtimi që kemi bërë, kemi vërejtur se në deklarinë e pasurisë së Visar Haxhibeqirit, është e dukshme se prindi i tij, Qamil Haxhibeqiri, merr pagë nga Kuvendi Komunal. Dhe që e ka pikërisht këtë pronë që po flasim të trashëguar [...]"

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dosjen/dokumentacion me propozimet për investime kapitale për vitin 2024-2025, të dërguar nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë (shkresa zyrtare: DPKI-06-338/25), lidhur me propozimin për restaurimin e shtëpisë së Beqir (Avdush) Haxhibeqiri. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përgjigje bashkë me dokumentacionin dhe informatat e kërkuara (shkresa zyrtare: DPKI-06-418/25).

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me shkresën zyrtare DPKI-06-01/482/25, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Visar Haxhibeqiri, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë z. Visar Haxhibeqiri, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë duke theksuar se, *‘Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturor janë institucione vartëse të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Shtëpia është pronë e babait. Si monumente i mbrojtur figuron që nga viti 1991, nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturor Gjakovë. Ndërsa që nga viti 2011, është në listën për mbrojtje të përkohshme të MKRS-së. Raporti për inventarizimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, është bërë nga ekipi profesional i Qendrës Rajonale në Gjakovë, dhe kalon përmes Drejtorit të QRTK. Planin e punës për investime kapitali e bënë Departamenti i Trashëgimisë Kulturor, për faktin se Qendrat nuk janë organizata buxhetore’*.

Pas trajtimit të këtij dokumentacioni, me qëllim të sqarimit të gjithanshëm të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga z. Haxhibeqiri informata plotësuese lidhur me procedurën e përfshirjes së projektit “Restaurimi i shtëpisë së Beqir (Avdush) Haxhibeqiri” në Gjakovë, në propozimin për investime kapitale për vitet 2024-2025.

Në informacionin plotësues (sqarues) me shkrim të dërguar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit nga zyrtari i lartë z. Visar Haxhibeqiri, theksohet se (citojmë): *‘[...] QRTK-të në kuadër të mandatit të tyre dhe me kërkesën e Institucioneve Qendrore dhe Departamentit të Trashëgimisë Kulturor (MKRS), çdo vit, bazuar në Raportin e Inspektimit/rivlerësimi dhe Inventarizimit të Monumenteve, propozojnë Monumentet të cilat kanë nevoja për intervenime adekuate. Si rregull, institucionet vartëse të MKRS-së në fushën e trashëgimisë kulturore, propozojnë gjithmonë një numër shumë më të madh të aseteve për ndërhyrje, bazuar në vlerësimet e gjendjes së tyre faktike të degradimit apo rrezikut të humbjes së vlerave. Ky numër, tutje, reduktohet/përshtatet nga ana e Departamentit për Trashëgimi Kulturor si departament përgjegjës për koordinimin e programit kombëtar të konservimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, me kufijtë buxhetor në dispozicion brenda vitit fiskal dhe dy (2) vite vlerësuese pasuese. Sqarojmë edhe njëherë, se kompetencat ligjore që burojnë nga Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligji 04/L-042 për Prokurimin Publik si dhe legjislacioni në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore (Ligji 06/L-113) dhe ai për zyrtaret publik (Ligji 08/L-197), i rezervohen njësisë organizative të*

MKRS-së, Departamentit për Trashëgimi Kulturore që e ka statusin e njësisë së kërkesës, Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS si autoriteti që e mbikëqyr punën e Departamentit për Trashëgimi Kulturore dhe Kabineti i Ministrit të MKRS-së. [..]’.

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur, dokumentacioni i siguruar sipas detyrës zyrtare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe sqarimet me shkrim të ofruara nga z. Haxhibeqiri, rezultojnë gjendja faktike si në vijim:

Raporti i punës për vitin 2023, nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjakovë, për Departamentin e Trashëgimisë Kulturore;

Aneksi 1. Projekt propozimet për vitin 2024, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjakovë, për Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, ku është përfshirë edhe projekti i intervenimeve emergjente “Shtëpia e Beqir (Avdush) Haxhibeqirit” Gjakovë;

Aneksi 2. Projekt propozimet për vitin 2025, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjakovë, për Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, ku është përfshirë edhe projekti i intervenimeve emergjente “Shtëpia e Beqir (Avdush) Haxhibeqirit” Gjakovë;

Raporti mbi procesin e inventarizimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Komunën e Gjakovës, Junikut dhe Klinës, nga Ekipi profesional i QRTK-Gjakovë, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS dhe Zv. Drejtorit të DTK-së, datë 06.12.2024;

Vendim me nr. 2079/2011, datë 30.09.2011, i Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me të cilin miratohet Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme. Kategoria II. Trashëgimia Arkitekturore. A. Nënkatëgoria Monument/Ansambël, Nr.629. “Shtëpia e Beqir (Avdush) Haxhibeqirit”.

Bazuar në gjendjen faktike si më lartë, si dhe në dokumentacionin në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Visar Haxhibeqir, për faktin se “Raporti mbi procesin e inventarizimit të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Komunat Gjakovë, Junik dhe Klinë”, i cili është hartuar nga ekipi profesional i QRTK-Gjakovë dhe që paraqet gjendja e monumenteve të cilat janë vlerësuar si me të rrezikuara dhe në nevojë për intervenim, është i adresuar tek Sekretari i Përgjithshëm i MKRS dhe tek zv. Drejtori i DTK-së, përmes z. Visar Haxhibeqiri në cilësinë e Drejtorit të QRTK-Gjakovë, si formë zyrtare e komunikimit, dhe për më tepër, i njëjti ‘Raport’ nuk është nënshkruar nga z. Haxhibeqiri.

Kësisoj, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit), paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Situata e konfliktit të interesit është e lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bazuar në dokumentacionin në dispozicion ka konstatuar se, z. Haxhibeqiri, nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, lidhur me përfshirjen e projektit "Restaurimi i shtëpisë së Beqir (Avdush) Haxhibeqiri" në Gjakovë, në listën e propozimeve për investime kapitale për vitin 2024-2025, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja në një çështje konkrete nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet situata e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, është fakt se në rastin konkret ekziston afërsia familjare, përkatësisht plotësohet njëri nga elementet thelbësore siç është interesi privat i personit të afërm, por mungon vendimmarrja si kusht tjetër kumulativ, prandaj në rastin konkret përjashtohet konflikti i interesit.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit se: “Kjo pronë, sipas regjistrave të tanishëm, ka qenë në ‘Mbrojtje të Përkohshme’, ndërkohë që tani rezulton të jetë vlerësuar me 250 mijë euro, çka ka bërë që të kalojë në ‘Mbrojtje të Përhershme’”, nga shqyrtimi i shkresave në lëndës rezulton se objekti “Shtëpia e Beqir (Avdush) Haxhibeqirit” figuron në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme që nga viti 2011. Po ashtu, kjo pronë vazhdon të jetë e përfshirë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme për periudhën (06.10.2024 - 06.10.2025). Qe e benë këtë monumente me një status që plotëson kriteret e mëhershëm të përcaktuara me Ligjin Nr.02/L-88 Për Trashëgimin Kulturore, për mbrojtje të përkohshme.

Në fund, zyrtarit të lartë në fjalë z. Visar Haxhibeqiri, i është bërë me dije se i njëjti gjithnjë duhet të ketë parasysh se gjatë ushtrimit të funksioneve publike të lartpërmendura, në rast se paraqitet ndonjë situatë e mundshme e konfliktit ‘rast për rast’ të interesit, sikurse ishte rasti i restaurimit të shtëpisë familjarit të tij, atëherë ai është i obliguar ta deklaroj atë dhe të tërhiqet nga vendimmarrja në ato raste, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 17 të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës)

Yll BULSHKAJ
Drejtari i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

